

ME FAT SI IRLANDEZËT - SI MUND TË JETË EMIGRIMI NJË E MIRË PËR BALLKAN

Alida Vračić

March 2019

SUMMARY

- Qeveritë e Ballkanit Perëndimor kanë dështuar në shfrytëzimin e potencialit të diasporës së tyre të madhe - plot gjashtë milion - në të gjithë botën.
- Kjo diasporë zotëron rrjetet, aftësitë dhe asetet, për të cilat kanë nevojë vendet e Ballkanit Perëndimor për t'u zhvilluar dhe për të pasur prosperitetet në një periudhë me një konkurrencë të ashpër ekonomike.
- Eksperiencia e Irlandës përcakton standardin: popullsia "Globale Irlandeze" e ditëve të sotme është një diasporë, e lidhur në një rrjet, e cila mbron interesat e irlandezëve në të gjithë botën dhe ka dhënë kontribute të rëndësishme në mrekullinë ekonomike të Irlandës.
- Për të ndjekur hapat e Irlandës, Ballkani Perëndimor duhet të mbledhë të dhëna në mënyrë urgjente, duke përfshirë realizimin e studimeve të detajuara për fuqinë punëtore, për të kuptuar diasporën në mënyrën e duhur dhe për të mësuar se si të komunikojë më mirë me të.
- Bashkimi Europian duhet të ofrojë ndihmë. Ai duhet të paraqesë programe për migrimin rrethor, në mënyrë që qytetarët e arsimuar të Ballkanit Perëndimor në shtetet anëtare të Bashkimit Europian të kthehen në vendet e tyre të origjinës të pajisur mirë, për të dhënë një kontribut edhe më të madh se ai që mund të kishin dhënë përpara se të largoheshin.

Parathënie

Pak rajone në Europë janë më shumë të prekura nga emigracioni sesa Ballkani Perëndimor.^[1] Megjithatë, pavarësisht se njerëzit janë larguar nga rajoni gjatë dekadave – shpesh për të mos u kthyer kurrë – emigracioni mbetet një problematikë për të cilën qeveritë e Ballkanit Perëndimor kanë qëndruar virtualisht në heshtje. Në rastet kur udhëheqësit politikë janë shprehur në lidhje me të, ata kanë bërë fare pak përveç thirrjes që emigracioni të ndalojë. Në tërësi, mbizotëron një gjendje plogështie. Qeverive të Ballkanit Perëndimor nuk iu duhet vetëm ta marrin situatën nën kontroll dhe të përcaktojnë politika dhe masa të qarta – po ato duhet të ndryshojnë plotësisht qëndrimet ndaj emigracionit. Është e vërtetë se nivelet e lartë të emigracionit shkaktojnë probleme, ashtu siç është e vërtetë se zgjidhja për shumë prej këtyre problemeve gjendet brenda vet emigracionit.

Gjatë dekadave të fundit, popullsia në Ballkanin Perëndimor është ulur në numër dhe është rritur në moshë. Po edhe pse janë larguar shumë njerëz, të dhënat rreth tyre mbeten të fragmentarizuara. Rajonit ende duhet të kuptojë se sa e dobishme mund të jetë diaspora për të ardhmen e tij – po edhe sikur ta donte ta arrinte këtë gjë, ai do të përballej me një mungesë të dhënash të dokumentuara, mbi të cilat do të mbështeste vendimet mbi politikat e reja. Ka pak analiza nga rajoni për efektet pozitive të emigracionit dhe për mënyrën se si qytetarët jashtë vendit mund të kenë një ndikim në vendin e tyre. Për ta ndryshuar këtë situatë, duhet të ndodhë një shndërrim i madh në marrëdhënien midis “atdheut” dhe personave të cilët kanë emigruar. Një gjë e tillë përfshin jo vetëm hapat për të ndryshuar narrativën e ngarkuar emocionalisht, e cila rrethon emigracionin, por edhe masa konkrete për të ndikuar në diasporën e Ballkanit Perëndimor. Nëse udhëheqësit e Ballkanit Perëndimor e shfrytëzojnë mundësinë, e ardhmja e rajonit mund të marrë përmasa globale.

Në të vërtetë, ka miliona qytetarë nëpër botë, të cilët shprehen se trashëgimia e Ballkanit Perëndimor do të mund ta ndihmojë rajonin të zhvillohet. Shpesh, ata zotërojnë aftësi unike, por rrjetet e tyre sidoqoftë, ekonomia dhe ndikimi i tyre mbeten të pashfrytëzuara. Kohët e fundit, remitancat janë fokusi i interesit të

qeverisë, por nëse do të kishte një qasje të organizuar për të shkuar pranë komuniteteve të Ballkanit Perëndimor jashtë vendit, kjo gjë do t'i inkurajonte ata ta investonin kohën, talentin dhe energjinë në rajon. Dhe në një epokë kur teknologjia digjitale e bën komunikimin më të lehtë se kurrë më parë, vendet e Ballkanit Perëndimor kanë një avantazh krahasuar me ato vende që e kanë provuar një gjë të tillë më parë.

Vende të tjera janë përballur me situata të ngjashme – dhe kanë përparuar për shkak të këtyre situatave. Udhëheqësit e Ballkanit Perëndimor duhet t'i kushtojnë veçanërisht vëmendje shembullit të Irlandës që prej viteve 1990 e në vijim. Për këtë arsye, ky material trajton eksperiencën e emigracionit irlandez dhe e krahason atë me tendencat e emigracionit në Ballkanin Perëndimor. Ai nënvizon përfitimet që do të mund të sillte në rajon një përpjekje e përbashkët e mbështetur nga qeveria. Por në të njëjtën kohë, thekson pasojat me të cilat ka mundësi të përballet Ballkani Perëndimor, nëse nuk ndryshohet qasja aktuale pasive ndaj emigracionit. Teksa çdo vend i Ballkanit Perëndimor ka eksperiencat dhe sfidat e veta specifike, në një këndvështrim të gjerë, të gjitha këto vende përballen me të njëjtat probleme të shkaktuara nga emigracioni, me nivelet e ulëta në investime dhe me qasje të dobëta për zhvillimin e diasporës.

Nëse vendet e Ballkanit Perëndimor do të duan të përmbushin qëllimet e tyre socio-ekonomike, është e rëndësishme që ata të ndryshojnë narrativën aktuale për emigracionin. Nuk është ekzagjerim nëse thuhet se e gjithë e ardhmja e Ballkanit Perëndimor varet nga mënyra se si e trajtojnë emigracionin vendet e rajonit. Për momentin, ata rrezikojnë të mbeten spektatorë të një largimi të vazhdueshëm, me shumë pak përfitime ndaj tyre apo qytetarëve të tyre. Nga ana tjetër, vendet e Ballkanit Perëndimor mund të rrëmbejnë mundësinë që i ofron emigracioni dhe të garantojnë për veten e tyre një të ardhme më të begatë, të hapur dhe me një rimëkëmbje të shpejtë.


Më pak në numër dhe më i moshuar: Ballkani Perëndimor sot

Në ditë e sotme njerëzit në Ballkanin Perëndimor nuk kanë më asnjë interes dhe po largohen nga vendet e tyre për shkak të papunësisë, dështimit të qeverisë për reforma si edhe për shkak të autoritarizmit, i cili po rritet gradualisht[2].

Në 30 vitet e fundit, gjashtë vendet e Ballkanit Perëndimor kanë humbur rreth një të dhjetën e popullsisë të tyre. Deri diku, kjo është pasojë e luftërave të viteve 1990: numri i të vdekurve vetëm në Bosnje-Hercegovinë ishte më shumë se 100 000. Ka mundësi që Shqipëria, Mali i Zi dhe Maqedonia të humbasin një pjesë të madhe të popullsisë së tyre – pothuajse një të dhjetën – deri nga mesi i shekullit. Për vende të vegjël, me pak emigracion hyrës që të shërbejë për kompensim, kjo situatë mund të jetë veçanërisht problematike. Ndërkohë që emigracioni ka lënë një strukturë të pafavorshme moshore në rajon. Të gjithë vendet e rajonit kanë popullsi në plakje, ku 15% e popullsisë janë të moshës 65 vjeç e më të moshuar. Parashikohet që kjo shifër të rritet në 26% nga mesi i shekullit. Deri në atë periudhë, rreth një e katërta e popullsisë së Ballkanit Perëndimor do të jetë 64 vjeç dhe më të moshuar.[3] Shtytja për t'u larguar është e fortë: një kërkim i kohëve të fundit nga Gallup tregon se pothuajse gjysma e banorëve të Serbisë të moshës 15-29 vjeç thonë se dëshirojnë të lënë vendin, shumë prej tyre përgjithmonë. Humbja në total e popullsisë në Kosovë arrin deri në 42% , duke përfshirë të rinjtë dhe të arsimuarit.

Duke pasur parasysh situatën ekonomike në Ballkanin Perëndimor, nuk vjen si i papritur fakti se njerëzit po largohen. Norma aktuale mesatare e pritshme e rritjes së GDP-së në Ballkanin Perëndimor, e cila është rreth 3%, është e pamjaftueshme për përshpejtimin e procesit për të arritur normën e vendeve të tjera europiane. GDP-ja është projektuar për të pasur një rritje prej 3.2% në vitin 2018 si edhe një rritje me 3.5% në vitin 2019, por nëse vazhdon kjo normë rritje, do të duhen gjashtë dekada që të ardhurat mesatare për frymë në Ballkanin Perëndimor të konvergohen me mesataren e BE-së. Një gjë e tillë nuk do të jetë mjaftueshëm, as për sa i përket mbështetjes së ambicieve më të gjera europiane të Ballkanit Perëndimor, dhe as për pritshmëritë e popujve për standardet e jetesës.

Të ardhurat për frymë në BE dhe në Ballkanin Perëndimor në vitin 2015



Qeveri të ndryshme të Ballkanit Perëndimor i janë adresuar angazhimit ndaj diasporës në mënyra të ndryshme, edhe pse asnjë prej tyre nuk ka përgatitur në të vërtetë një model, i cili përmbush potencialin e këtij procesi. Për shembull, Ministria e Shtetit për Diasporën është një departament i krijuar rishtazi nga qeveria shqiptare, përgjegjëse për komunikimin dhe trajtimin e çështjeve me ndikim në diasporën shqiptare. Ndërkohë, Ministria e Fesë dhe e Diasporës ishte një departament i qeverisë serbe, përgjegjëse për lidhjet me diasporën, por në vitin 2012, kjo njësi u bashkua me Ministrinë e Kulturës dhe të Informacionit. Problemi, i cili nuk pranohet, është se këto

ministri kanë pak peshë politike, burime dhe rëndësi publike.

Megjithatë, ndoshta është i vetëkuptueshëm fakti se qytetarët e Ballkanit Perëndimor, të cilët punojnë jashtë vendit, arsimohen atje, dhe bëhen të suksesshëm. Si rezultat, ata paraqesin një mundësi të rëndësishme për vendet që kanë lënë pas. Në të vërtetë, imagjinoni, të kundërtën e situatës, në një vend të pasigurt, qytetarët e të cilit nuk largohen, një vend i cili nuk kërkon kurrë rrjetet e mundshme për të ndërhyrë. Për këtë arsye, qeveritë e Ballkanit Perëndimor duhet të përgatisin politika të cilat krijojnë rrjetet për të lidhur emigrantët me vendet nga ku janë larguar, dhe në fund, t'i inkurajojnë ata të kthehen me aftësi, asete dhe me një impakt financiar. Zhblokimi i investimeve të diasporës të cilat ndihmojnë në ekosistemin e sipërmarrjes në vendet e tyre të lindjes mund të inkurajojë lidhjet midis njerëzve dhe mund të stimulojë rritjen ekonomike në mënyrë të drejtpërdrejtë.

Faktikisht, vendet e Ballkanit Perëndimor nuk do të ishin të parët, që do ta ndërmerrenin këtë rrugë. Si pikë frymëzimi, ata mund t'i referohen një vendi europian: Irlandës. Kohë më parë, Republika e Irlandës kundër-reagoi ndaj frikës nga emigracioni duke u përqendruar në thesarin e mundësive të arta, të cilat emigracioni mund t'i kanalizojë drejtpërdrejtë në vendin e origjinës.

Irlanda dhe emigracioni: Uji që kthehet në verë

“Diaspora irlandeze ‘mund të na ndihmojë shumë që të mund të riimagjinojmë Irlandën’ dhe ‘rigjejmë besimin tonë, veçanërisht në kuptimin ekonomik’”.


Në mes të viteve 1990, Mary Robinson, presidentja e Irlandës në atë kohë, iu adresua parlamentit irlandez dhe hapi tematikën delikate mbi diasporën e madhe të vendit të tyre. Ajo trajtoi çështjen që, në fakt, komuniteti i emigrantëve mund të ishte me rëndësi të madhe përfituese për Irlandën. Robinson rikujton: “[Mesazhi] ra si bombë... unë u largova plotësisht e stresuar, por më pas filluan të vinin mesazhe nga e gjithë bota,”... emigrantët e mbanin mend atë më së shumti për fjalimin”.

Por duke e riimagjinuar diasporën irlandeze të përbërë nga individë energjikë, aktivë

dhe të udhëhequr nga forca e vullnetit, në historinë e Irlandës u hap një kapitull i ri. Sot, Irlanda është vendi i Google-it dhe i Microsoft-it, ku mijëra qytetarë të saj punojnë në frontet e teknologjisë. Ajo tërheq talentin nga e gjithë bota. Sipas Bankës Botërore, Irlanda është një nga ekonomitë me rritjen më të shpejtë në BE dhe e ka ruajtur këtë pozicion në vitet e fundit, fal një game të tërë politikash.

Ashtu si edhe në Ballkanin Perëndimor sot, edhe në Irlandë emigracioni ishte një tematikë e vështirë dhe shumë e ndjeshme në diskursin publik. Ashtu si në Ballkanin Perëndimor, largimi i qytetarëve irlandezë me arsim të lartë ishte një tendencë e theksuar. Vetëm në vitin 1988, nga Irlanda u larguan 70,600 qytetarë, shumica e të cilëve kishin diploma.[4] Debati në Irlandë rreth emigracionit e trajtonte atë vetëm si një nevojë të pashmangshme më shumë sesa një mundësi. Por, në vitet 1990, fjalimet e tilla si fjalimi i Robinsonit dhe masa e organizuar e qeverisë filluan ta ndryshojnë këtë gjë.

Niveli arsimor i emigrantëve irlandezë 2008-13



Qeveria irlandeze ndërmori një sërë masash për të kuptuar diasporën irlandeze anembanë në botë dhe rrjetet që ajo krijonte. Organizatat e shoqërisë civile e mbështetën këtë përpjekje, duke vepruar sipas një kuadri gjithëpërfshirës, i krijuar nga qeveria. Këto iniciativa përpiqeshin të identifikonin përfitimet që shkonin për Irlandën nga potenciali i diasporës. Qeveria financoi kërkime të reja, i mbështeti masat e saj në të dhëna të besuara, dhe shfrytëzoi teknologjinë në zhvillim për të fuqizuar lidhjet me

diasporën.

Një përpjekje e tillë, u ndërmor në vitin 1996, nga Forbairt (kohët e fundit, *Enterprise Ireland*), duke shënjestruar “komunitetet e emigrantëve irlandezë jashtë vendit”, për t’i inkurajuar ata të ngrinin biznese në vendlindjen e tyre. Në vitin 1999, Raporti Harvey shqyrtoi politikat dhe shërbimet e ofruara nga qeveria, duke arritur në konkluzionin se kishte nevojë për një garanci më të madhe nga qeveria, veçanërisht për sa kishte të bënte me financimin dhe infrastrukturën. Raporti parashikonte se këto përpjekje do të mbështeteshin në të ardhmen nga një Task Force, nën koordinimin e Departamentit të Punëve me Jashtë dhe Tregtisë, dhe do të përfshinin departamente qeveritare, agjenci shtetërore dhe organizata jo qeveritare.

Në raportin e saj të vitit 2002, task forca sugjeronte ngritjen e një njësie të re për të mbështetur shtetasit irlandezë jashtë vendit si edhe për të mbledhur shumë fonde. Në mbështetje të rekomandimeve, Departamenti i Punëve me Jashtë çeli Njësinë për Mbështetjen e Emigrantëve, duke përfshirë iniciativa të reja, të tilla si: Forumi Global Qytetar Irlandez, Fondacioni për Sfidat e Alumnit, Fondin e Angazhimit të Diasporës Lokale, Një Qendër Globale Irlandeze si edhe Fondi Global i Medias Irlandeze (i cili synonte të ofronte mbështetje në trajtimin e diasporës irlandeze). Që prej vitit 2004, qeveria irlandeze ka dhënë fonde për 34 shtete në mbështetje të komunitetit irlandez në rang global.^[5]

Rritja e popullsisë në Irlandë 2017-2018



	2017	2018
Imigrimi	84,600	90,300
Emigrimi	64,800	56,300
Migrimi neto	19,800	34,000
~Prej të cilëve shtetas irlandezë	-3,400	100
Rritje natyrore	33,100	30,500
Ndryshimi i popullsisë	52,900	64,500
Popullsia	4,792,500	4,857,000

Burimi: Central Statistics Office

Në fillim të viteve 2000, u duk se emigrimi masiv irlandez mund të ishte diçka që i përkiste të shkuarës. Por ky nuk ishte një trend që vazhdoi: në vitin 2008, në mes të krizës ekonomike globale, 240000 irlandezë u larguan nga vendi i tyre. Irlandës iu deshën disa vite të rimëkëmbej, të përmirësonte ekonominë e saj dhe të tërhiqte përsëri njerëz të rinj dhe të talentuar. Qeveria përshpejtoi shkëmbimet me emigrantët dhe dekadat e izolimit fizik për shumë persona jashtë vendit, duke arritur kulmin në vitin 2013, me [“Kthimin në Atdhe](#). Njerëzit me rrënjë irlandeze, të cilët jetonin gjithandej, nga Mbretëria e Bashkuar në Gjermani dhe deri në Australi, u rikthyen në Irlandë. Në vitet në vijim, angazhimi i pandërprerë i qeverisë rezultoi në një sërë arritjesh të mëdha, duke përfshirë projekte të reja universitare për të trajtuar emigracionin bashkëkohor irlandez.^[6]Nivele të ndryshme brenda qeverisë irlandeze janë përfshirë në angazhimin për diasporën. Për shembull, Këshilli i Kontesë së Donegalit përgatiti një aplikacion të quajtur *Diaspora Global Skills Locator* (Matësi i Aftësive Globale të Diasporës),^[7]një risi dhe një mënyrë inovatore për të lidhur

aftësitë e njerëzve me mundësitë në Irlandë, duke përdorur teknologjinë GIS, të ndërtohet në një hartë interaktive.[8]

Në vitin 2015, qeveria p[ublikoi “Irlandezi Global: Politika e Diasporës së Irlandës” dhe krijoi Komisionin Ndërmintor për Irlandezët Jashtë Vendlindjes, i kryesuar nga ministri për diasporën. Secili departament vepron me autonomi si edhe mbështetur në strategjinë e tij. Ky ishte një hap i rëndësishëm, sepse të gjithë nivelet e qeverisë do të duhej t'i referoheshin planeve nëse dëshironin të kishin sukses. Dhe, në vitin 2016, qeveria irlandeze përgatiti një [raport të pavarur për ekonominë](#), ku trajtoheshin problematikat, të cilat në të kundërt të përpjekjeve, nuk i bindnin qytetarët irlandezë të ktheheshin në vendlindje, duke hapur në këtë mënyrë një rrugë të qartë për të nisur heqjen e këtyre barrierave. Një organizatë e shoqërisë civile ndihmoi në përgatitjen e raportit, duke ofruar njohuri të dorës së parë mbi problematikat dhe duke identifikuar barrierat e tilla si mosnjohja e kualifikimeve.[9] Paralelisht, ata [hartuan dy katalogë](#), të cilët ndihmonin në lokalizimin e anëtarëve të diasporës irlandeze në të gjithë botën.

Ku është Chuck Feeney i Ballkanit Perëndimor?

Të dhënat dhe rrjetet e përmirësuar mund t'i ndihmojnë vendet të depërtojnë në diasporat e tyre globale. Megjithatë, angazhimi i qeverisë ndaj marrëdhënieve me diasporën mundësojnë investimin dhe mbështetjen financiare nga individë, të cilët bëjnë ndryshimin. Përsëri, në këtë rast, shembulli i Irlandës është instruktiv: në vitin 1998, Chuck Feeney, një filantrop me banim në Shtetet e Bashkuara të Amerikës, me origjinë irlandeze, i bëri një ofertë të madhe qeverisë në Dublin. [Ai i ofroi qeverisë një donacion prej 75 milion paund britanikë – nëse qeveria i përdorte këto të ardhura diku](#). Brenda një jave, Bertie Ahern, kryeministri në atë periudhë, bëri publik programin prej 150 milion paund britanikë për Kërkime në Institucionet e Nivelit të Tretë (KINT). Që prej atij momenti, KINT rezultoi të ketë një rikthim të drejtpërdrejtë ekonomik kundrejt investimit, prej £1.8 miliard, duke e bërë atë [projektin](#) më të suksesshëm, të ndërmarrë ndonjëherë në çdo vend të botës nga Grupi i Feeney-t me Filantropët e Atlantikut. Po e njëjta iniciativë ishte baza për suksesin e mëvonshëm të Agjencisë për Zhvillimin Industrial të Irlandës (AZHI), e cila tërheq investitorët e mundshëm të huaj

në Irlandë. Organizata e Feeney-t me Filantropët e Atlantikut ka ofruar të ardhurat bazë për çeljen e bibliotekave, godinave shkencore dhe fshatrat e studentëve. Në një ekonomi në ndryshim e sipër, Irlanda u kthye nga një vend me popullatë emigruese, në vendin i cili tërheq njerëzit; kërkimet dhe teknologjia e informacionit ishin çelësi i suksesit.

Sot, Irlanda është një vend me pothuajse 5 milion banorë, me më shumë se 70 milion emigrantë së bashku me pasardhësit e tyre të përlllogaritur në të gjithë botën. Në të vërtetë, si shembull për vende me diaspora të mëdha, sado e dhimbshme është humbja e njerëzve, ky komunitet global irlandez as nuk do të kishte ekzistuar, nëse nuk do të ishin larguar kaq shumë shtetas. Ashtu siç e ka thënë - hapur - një vëzhgues, nëse do të ishin ushtruar kufizime për emigracionin në Irlandë, për t'i ndaluar njerëzit në të shkuarën që të largoheshin, “Tani, Irlanda do të ishte një vend me 14 milion banorë, por do të ishte shumë më e varfër dhe më e shëmtuar”.^[10] Sigurisht, Irlanda ka problemet e veta, të tilla si një mungesë akute për strehim, ndërkohë që duhen bërë ende përmirësime të ndjeshme në shëndetësi dhe në arsim. Por, tashmë, me një të tretën e popullsisë së saj, nën moshën 25 vjeç, sipas [AZHI Irlandë](#), në vitin 2010, Irlanda kishte atë ç’ka Komisioni Europian e quante: “Të diplomuarit më të punësueshëm në botë”. Vitet e bashkëpunimit dhe të investimeve në arsim kanë ndihmuar në krijimin e një force punëtore shumë të aftë dhe në krijimin e sektorëve konkurrues në rend global në shkencë dhe teknologji, në vend.

Irlanda ka një nga marrëdhëniet më të zhvilluara në botë midis atdheut dhe diasporës së tij. Sidoqoftë, njësi shumë të zhvilluara të rrjeteve të lidhjeve sjellin në vend punësime, investime dhe njerëzit, si edhe lehtësojnë migrimin rrethor (angazhimi i vazhduar i emigrantëve si në atdhe edhe në vendet e pritjes). Gjithashtu, nuk ka dyshim se komuniteti global irlandez, i cili ka dalë nga ky aktivitet, është thelbësor në përkrahjen e vendit dhe në mbështetjen e jashtëzakonshme të reputacionit të Irlandës. Kultura irlandeze nuk është e njohur në botë, por vet vendi është i njohur në rang ndërkombëtar. Historia e trazuar nuk e ka ndaluar Irlandën në ndërmarrjen e kësaj kthese. Mësimet për vendet e Ballkanit Perëndimor ka mundësi të jenë të gjata,

por ia vlen që ato të mësohen.

Çfarë mund të mësojë Ballkani Perëndimor nga Irlanda?

Vendet e Ballkanit Perëndimor duhet të përqendrohen në elementet e mëposhtëm përfituar nga eksperiencia e Irlandës: fillimisht, duhet nisur dialogu mbi emigracionin; së dyti, duhet të fillohet të krijohen rrjete; dhe së fundi, të mbështeten investimet, nivelet e aftësive si edhe mundësitë e punësimit që sjellin këto lidhje të mirë-zhvilluara.

Aktualisht, është tronditëse teksa konstatohet se qasja e qeverive të Ballkanit Perëndimor për diasporën, e cila prek të gjithë, është një-dimensionale. Nëse ka një fokus, ai shkon tek remitancat. Edhe pse ato kontribuojnë në stabilitetin financiar në rajon, remitancat janë vetëm njëra lidhje me diasporën. Qeveritë vazhdojnë të anashkalojnë potencialin e migrimit qarkor dhe të investimeve të drejtpërdrejta të diasporës (IDD). Këto masa shkojnë përtej përfitimeve financiare, ato shërbejnë për të përfshirë lidhje të fuqizuara kulturore dhe sentimentale midis individëve në diasporë dhe atdheut të tyre.

Të dhëna:

Qeveritë e Ballkanit Perëndimor, në mënyrë urgjente, duhet të adresojnë mungesën e tyre relative në të dhëna për qytetarët e tyre - si edhe mungesën në të dhënat për trashëgiminë e Ballkanit Perëndimor, e cila mund të mos përfshijë qytetarët. Për të kuptuar në mënyrën e duhur potencialin e rrjeteve të diasporës së tyre, ata duhet të përmirësojnë sistemet e tyre për mbledhjen e të dhënave, duke u mbështetur në atë ç'ka është e disponueshme nga censuset. Është shumë e rëndësishme të identifikohet ajo ç'ka është e njohur si edhe “të panjohurat” e panjohura. Një aktivitet i tillë ka mundësi të kërkojë ndërmarrjen e proceseve për mbledhjen e të dhënave administrative (si ato për mbledhjen e të dhënave mbi profesionet dhe aftësitë) dhe të anketimeve vendore periodike, të cilat mund të kushtojnë fare pak nëse mbështeten në një census. Për të ilustruat problemin siç qëndron aktualisht, në Dhjetor 2018, në Bosnje, në një deklaratë për shtyp u raportua se një format për një anketim statistikor

i përgatitur për të mbledhur informacione për qytetarët boshnjak, të cilët jetojnë jashtë vendit, mori përgjigje nga vetëm 5-6% e të adresuarve. Ky [raport](#) theksonte se këto të dhëna ishin të pamjaftueshme për të marrë të dhëna statistikore të besueshme për numrin e personave, të cilët jetojnë jashtë vendit.

Për më tepër, duke pasur parasysh shkallën e emigracionit nga rajoni, është e rëndësishme që qeveritë të realizojnë një anketim më të detajuar për fuqinë punëtore në moshë pune si në vendet e Ballkanit Perëndimor edhe jashtë vendit. Kjo do të ndihmonte në mënyrë të drejtpërdrejtë procesin ekonomik dhe atë të zhvillimit të qeverisë, të sinkronizuar me të dhënat e emigracionit. Gjithashtu, qeveritë duhet të marrin në konsideratë me kujdes çeljen e përfaqësive kombëtare në vendet e ngulmimeve më të mëdha si edhe realizimin e regjistrimit për qytetarët e Ballkanit Perëndimor të cilët jetojnë jashtë vendit (duke përfshirë anketimin e aftësive dhe të kualifikimeve të tyre). Një gjë e tillë mund të shoqërojë një fushatë informuese, e cila do të përfshinte vizita të rregullta në komunitetet e diasporës nga zyrtarët qeveritarë. Për të qenë e vlefshme, një strategji zhvillimi duhet të përfshijë projektimet e të dhënave për emigracionin dhe imigrimin- dhe në këtë pikë, do të jetë e nevojshme ekspertiza e demografëve dhe e gjeografëve.

Është i rëndësishëm edhe fakti se Bashkimi European duhet të luajë një rol në adresimin e mungesës së aksesit për rajonin në të dhënat e besueshme. Me anë të agjencive të tilla si EUROSTAT, BE duhet të ofrojë udhëheqje teknike për mbledhjen dhe hartimin e të dhënave të unifikuara. Një ndihmë e tillë mund të shërbejë për regjistrimin administrativ, anketimet tre-mujore, projektimet shumë cilësore të ekspertëve dhe në ndërmarrjen e metodologjive, të cilat mund të përfshihen dhe të përdoren për emigracionin në strategjitë e së ardhmes. Ka shumë mundësi që rajoni të mos mund të arrijë një zhvillim të madh në këtë aspekt pa ekspertizën nga jashtë; BE është partneri kryesor më i afërt dhe më logjik për të kontribuar në këtë përpjekje.

Rrjetet

Normalisht, njerëzit ndërtojnë lidhje midis njëri-tjetrit pa ndërhyrjen e qeverisë. Tashmë ekziston një ndërveprim i shpeshtë dhe i vazhdueshëm midis anëtarëve të

diasporës, si edhe midis diasporës dhe vendeve amtare. Aktualisht, qeveritë e Ballkanit Perëndimor kanë mungesë të theksuar njohurish për llojet e ndërveprimit, të cilat tashmë ekzistojnë midis qytetarëve që jetojnë jashtë vendit dhe atyre në atdhe. Një perceptim i thellë i këtyre rrjeteve do t'i ndihmonte qeveritë të kuptonin më mirë thesarin e dijeve që përfaqësojnë ata.

Në vendet e Ballkanit Perëndimor, tashmë ekzistojnë iniciativa për angazhimin e diasporës të ngjashme me ato në Irlandë, por deri më tani, ato kanë pasur më pak ndikim. Shumica e vendeve të Ballkanit Perëndimor kanë politika dhe strategji për angazhimin e diasporës, të tilla si: Strategjia për Zhvillim dhe Strategjia e Zhvillimit të Shkencës, në Bosnja-Hercegovinë. Ndërkohë, Mali i Zi ka organizuar takime jozyrtare nën emërtimin “Le të takohemi në qytetin tuaj” si mënyrë për të krijuar një rrjet lidhjesh. Ekzistojnë **mekanizma dhe fonde** të cilët i dedikohen rritjes së numrit të individëve jashtëzakonisht të aftë dhe të talentuar, që rikthehen; si edhe një sërë planesh veprimi dhe strategji për të rinjtë për bashkëpunim me diasporën. Megjithatë është e nevojshme të ndërmerren hapa thelbësorë për të krijuar lidhje më të drejtpërdrejta midis vendeve të origjinës dhe qytetarëve të Ballkanit Perëndimor, të cilët jetojnë jashtë.^[11]Gjithashtu, ekzistojnë një sërë iniciativash të tjera, por ato kanë pasur një sukses të kufizuar deri më tani. Shembujt përfshijnë qendrën ENIC/NARIC në Serbi si edhe *Bosnia Restart*, një ambasadë biznesesh për diasporën dhe investitorët e huaj.

Qeveritë e Ballkanit Perëndimor duhet të identifikojnë shembujt e praktikës më të mirë, duke u përqendruar veçanërisht në eksperiencën e Irlandës. Ata duhet t'i kalojnë më shumë pushtet dhe financime këtyre strukturave për të arritur rezultate. Brenda vendit të origjinës, qeverisë i duhet të ndërmarrë një koordinim më të madh ndëradministrativ për të garantuar se përgjegjësia për emigrimin do të shkojë për më shumë sesa një ministri. Së fundmi, Kriteret e Kopenhagës për hyrjen në BE parashikojnë një bashkëpunim rajonal midis vendeve të Ballkanit Perëndimor. Një bashkëpunim i tillë për emigracionin duhet të ketë si qëllim që të gjitha vendet të ndajnë një kuadër të plotë në lidhje me natyrën dhe shkallën e emigracionit.

Duke qenë se rrjetet tashmë janë digjitale, qeveritë duhet të përshtatin qasjen e tyre

për ta shfrytëzuar teknologjinë sa më shumë të jetë e mundur. Njerëzit të cilët largohen nga rajoni tashmë janë të mirëinformuar në aspektin digjital, në një epokë ku aksesimi në informacione dhe në zhvillimet e përditshme nuk ka qenë kurrë më mirë. Format e reja të teknologjisë dhe të komunikimeve lehtësojnë emigracionin duke e bërë procesin e aplikimit për një vizë dhe gjetjen e një pune më të lehtë se kurrë, si edhe mundësojnë punësimin virtual. [Kërkimet](#) tregojnë se forumet online dhe rrjetet sociale tërheqin qindra mijëra njerëz për të diskutuar zhvillimet e përditshme në vendin e origjinës. Qytetarët e Ballkanit Perëndimor, të cilët jetojnë jashtë, mund të jenë të irrituar dhe të mërzhitur me lidhshimin e tyre politik, por lidhjet me vendet e tyre janë ende të forta. Për ata miliona persona të cilët janë larguar nga rajoni, platformat më të njohura të komunikimit tashmë janë WhatsApp-i, Skype-i dhe Twitter-i.

Krijimi i programeve efikase për fuqizimin e lidhjeve midis atdheut dhe emigrantëve do të jetë një hap i rëndësishëm përpara. Nëse qeveritë bëjnë si qëllim të tyre përfundimtar garantimin që idetë, aftësitë dhe burimet financiare të emigrantëve të mund të kthehen në një kontribut për Ballkanin Perëndimor, ato duhet të ndërmarrin hapat e nevojshëm për të garantuar që mundësitë për edukim dhe ato ekonomike të jenë mjaftueshëm tërheqëse për t'i tunduar ata të kthehen përsëri.

Emigrim me ritme të fuqishme

Aktualisht, politikat e qeverive të Ballkanit Perëndimor, natyra e vogël dhe e fragmentuar e tregjeve kombëtare në rajon si edhe perceptimet që mbizotërojnë në lidhje me korrupsionin dhe arritjet e pamjaftueshme në biznes kombinohen për të penguar perspektivat për rritjen e rajonit. Perspektivat transformuese për arsimin, punësimin dhe investimet në atdhe, do të jenë, në këtë mënyrë, thelbësore në transformimin e emigrimit nga një fenomen negativ në diçka pozitive.

Në të vërtetë, ekziston një marrëdhënie e ndërsjellët përfituese midis progresit në përmirësimin e të dhënave për flukset, rrjetet, arsimin në migrim dhe krijimin e punësimit; secila do të rrisë cilësinë e tjetrës. Një gjë e tillë manifestohet në investimet e huaja direkte të kufizuara në rajon. Sipas një raporti të Bankës Botërore, fondi i

investimeve e huaja direkte për frymë në vendet e Ballkanit Perëndimor (2 600 € në vitin 2015) është më pak sesa gjysma e fondit në vendet europiane lindore anëtare në BE dhe vetëm një e shtata e mesatares së BE-së.[12]

Pavarësisht kësaj gjëje, IDD mbetet një aspekt shumë pak i trajtuar. Nivelet aktuale të investimeve, të bëra nga vendet në Ballkanin Perëndimor nuk duket se do ta transformojnë këtë situatë në një të ardhme të afërt. Kjo është veçanërisht e vërtetë për arsimin, shkencën dhe zhvillimin. Mesatarisht, ata shpenzojnë **më pak se 0.4% të GDP-së** për kërkimet dhe zhvillimin. Pa investime më të fuqishme, individët e talentuar do të vazhdojnë të largohen. Financa dhe format e tjera të ndihmës nga jashtë kanë rëndësi në ndryshimin e kësaj situatë, veçanërisht për shkak të konkurrencës së egër globale dhe mungesës në kapacitete dhe në burime.

Programet financuese për kërkime të BE-së duket se janë të disponueshme vetëm për disa raste.

Për adresimin e disa prej këtyre sfidave, qeveritë e Ballkanit Perëndimor duhet të nisin pa humbur kohë të krijojnë një mjedis, i cili mbështet shkencën, arsimin, inovacionin dhe industrinë e teknologjisë së informacionit. **Shumë prej atyre që kanë emigruar nga rajoni në fillim të viteve 1990, tashmë kanë kërkuar aftësi dhe eksperiencë, si edhe kanë kapitalin që do të mund ta përdorin për të mbështetur projekte dhe ide të reja.** Është në interesin e qeverive në rajon që jo vetëm t'i mbajnë njerëzit në vend duke iu ofruar programe të rëndësishme, por edhe të tërheqin të tjerë nga jashtë. Kompanitë do të hyjnë në tregjet lokale, nëse besojnë se janë krijuar kushtet e duhura, diçka e cila varet nga profili i kompanisë, veçanërisht: aftësitë, talenti dhe mosha. Ballkani Perëndimor është i pasur në mundësi punësimi, por mbetet larg nga mundësia për të qenë një vend “me talentet e duhura”. Tregjet e punës së fragmentarizuar dhe relativisht të vegjël, të cilët shpenzojnë pak në kërkime duhet të punojnë për të rritur cilësinë më shumë sesa volumin e aftësive të tyre. Por nëse ata nuk bëjnë investime të reja dhe nuk shfrytëzojnë teknologjinë e avancuar, industritë nuk do të mundën kurrë të arrijnë potencialin e tyre të plotë.

Për shembull, industria e teknologjisë së informacionit është rritur me ritme të shpejta në Ballkanin Perëndimor, por ajo që i pengon kompanitë janë strukturat e


papërshtatshme të migrimit rrethor në këto vende, një gjë e tillë i pengon kompanitë në shumë sektorë. Për shembull, kompania *Nordeus*, me bazën e saj në Beograd, është një nga startup-et më të suksesshme në botë, me zyra në Dublin, Londër, San Francisko, Shkup dhe Beograd. Ajo ka 170 punonjës dhe më shumë sesa 100 milion produkte të shkarkuar. Hapat e ndërmarrë për lehtësimin e migrimit rrethor, duke përfshirë qytetarët e Ballkanit Perëndimor do të ndihmonin kompani si kjo e fundit, të cilat aktualisht janë të detyruara të mbushin boshllëkun e krijuar nga qeveritë joaktive dhe të tërheqin vet punonjësit të kthehen në Serbi. Një rritje në këtë front do të mundësonte që rajoni të tërhiqte edhe forcën punëtore e cila nuk vjen nga Ballkani Perëndimor, por që tërhiqen këtu për shkak të rigjallërimit të ekonomisë. Një gjë e tillë do të nxirrte si një detyrim për qeveritë të menaxhonin me kujdes proceset paralele për të tërhequr qytetarët që të rikthehen, duke inkurajuar në të njëjtën kohë edhe imigrimin.

Në mbështetje të kësaj politike, vendet e Ballkanit Perëndimor duhet të inkurajojnë në mënyrë të qartë IDD-të. Ndryshe nga investimi standard direkt i huaj ose konsumi afatshkurtër që nxisin remitancat, IDD mund të ketë një element të emigrimit, i cili përcakton një super strukturë me një ndikim të rëndësishëm në vendin e synuar. Kjo ndodh sepse investitorët-emigrantë janë të gatshëm të ndajnë aftësitë, teknologjinë dhe pronën intelektuale me vendet e tyre të origjinës. Dhe, duke pasur parasysh korrupsionin dhe probleme të tjera të rrënjosura nëpër vendet e rajonit, kthimi i emigrantëve, të cilët do të presin dhe kërkojnë standarde më të larta demokratike, mund të ndihmojë për të pasur ndryshime të tjera, teksa qeveritë kuptojnë se duhet t'i bëjnë gjërat ndryshe për t'i tërhequr ata.

Tashmë rajoni ka një sërë rrjetesh, të cilët janë shfaqur gradualisht si rezultat i emigrimit dhe operojnë jashtë kontrollit shtetëror. Këto rrjete mbështesin zhvillimin e bazuar në dije dhe lehtësojnë rrugën për t'u rikthyer. Shembuj që e ilustronjë këtë gjë përfshijnë *Akademine Amerikane të Arteve dhe Shkencës në Bosnje-Hercegovinë*, *Rrjetin e Migrimit të Ballkanit Perëndimor* dhe grupin jofitimprurës “*Perspektiva jonë*” (krijuar në vitin 2016). Dhe ashtu siç e demonstroi edhe shembulli i Fenney dhe qeverisë së Ahern, filantropia mund të çojë drejt një zhvillimi të ri. Për shembull, edhe

pse në fillimet e veta, puna filantropike në Ballkanin Perëndimor tashmë ekziston dhe me shumë mundësi kontrollon **35 milion euro për financime në gjashtë vende në rajon**. Fondacioni *Catalyst Balkans* është një shembull konkret. Ai synon të zhvillojë filantropinë në Ballkanin Perëndimor. Kërkimet e këtij programi tregojnë se në vitin 2016 Kosova mori një total prej 10.2% të të gjithë donacioneve dedikuar arsimit, krahasuar me 34.4% dedikuar uljes së varfërisë. Nuk ka asgjë të regjistruar për forma të tjera investimesh, si investimi në shkencë dhe në arte. Iniciativa te reja të kohëve të fundit, të tilla si **ato që janë ndërmarrë nga tenisti serb Novak Djokovic**, ndjekin një strukturë investimesh filantropike, të cilat e kthejnë fitimin në një të ardhme të largët (në rastin e tij, në kërkimet për fëmijët). Por ndihma aktuale përqendrohet në masat paraprake. Një gjë e tillë mund të ulë ndikimet e varfërisë në aspektin afatshkurtër, por mund të ketë pasoja ndaj investimeve, të cilat i marrin rezultatet në perspektivën afatgjatë.

Qëllimi i donacioneve filantropike në Ballkanin Perëndimor (katër kategoritë kryesore %)



Qeveritë e Ballkanit Perëndimor kanë mundësinë të krijojnë një rreth ekonomik të drejtë. Teksa ato shtrijnë ndikimin e tyre me anë të rrjeteve dhe përkushtimit për të qenë pranë komuniteteve të diasporës, ato do të përmirësojnë kapacitetet e tyre për të filluar të tërheqin punonjës të aftë, të cilët, do t'ua shpërblejnë ndihmën, duke i

ndihmuar të zhvillohen në rend social, në arsim dhe ekonomi. Për momentin, një mungesë kronike e punësimit i shkurajon njerëzit të vendosin të kthehen.[13] Qeveritë po bëjnë fare pak punë për të përmirësuar mjedisin e përgjithshëm për punë, aftësi dhe investime.

Megjithatë, të tilla përpjekje nuk duhet të bëhen vetëm për paratë. Për shembull, për përmirësimin e aftësive dhe njohurive, [arsimi shkencor virtual në BE mund të ndihmojë me zgjidhje të shpejta për informim dhe për të mbajtur pronën intelektuale në vend](#): Kolegje nëpër Europë ofrojnë leksione online nga të cilat mund të përfitojnë komunitetet shkencore, studentët dhe kërkuesit në Ballkanin Perëndimor. Nëse Bashkimi European do të ofronte solidaritetin dhe fondet e veta strukturore për vendet në rajon si edhe nëse do t'i përqendronte ato në fusha të tilla si arsimi, një gjë e tillë do të ndryshonte ndjeshëm perspektivën për Ballkanin Perëndimor.

Bashkimi European dhe migrimi rrethor


BE është me të vërtetë një faktor madhor në përpjekjet e Ballkanit Perëndimor për të gëzuar përfitimet nga rrjetet e emigrantëve. Përsëri, duke iu rikthyer shembullit të Irlandës, është e rëndësishme të merret në konsideratë roli që mund të luajnë “fqinjët më të afërt”. Një pjesë e rëndësishme e migrimit rrethor, i cili historikisht i ka sjellë përfitime Irlandës, ka ndodhur midis saj dhe Mbretërisë së Bashkuar. Kjo rrugë e mirë-organizuar ka mundësuar aksesin në një treg më të madh dhe më të pasur pune, duke ofruar mundësi thjeshtë fal afërsisë territoriale (si edhe gjuhës së përbashkët). Shumë e kanë bërë dhe vijojnë ta bëjnë disa herë udhëtimin nga njëri vend tek tjetri, në kërkim si të punësimit edhe të kualifikimeve.

Edhe BE e ndihmoi Irlandën në sferën e arsimit. Kur vendi u bashkua në BE në vitin 1973, [vetëm 27,135 studentë irlandezë arritën në nivelin e tretë të studimeve](#). Në vitin 2015, pasi u shfrytëzua plotësisht ndihma financiare e Bashkimit European për arsimin, ajo shifër shkoi [173,649](#). Gjendja e arsimit në Irlandë ndryshoi ndjeshëm për shkak të një totali prej 6.5 miliard euro investimesh nga Fondi Social European. Së bashku me Komisionin European, qeveria irlandeze caktoi burime të rëndësishme në këtë fushë, duke pranuar se, për të arritur konvergjencën afatgjatë me vendet e tjera të BE, nuk

mund të kishte asnjë alternativë tjetër për një kapital më të madh njerëzor.[14]

Bashkimi European strehon shumë emigrantë nga Ballkani Perëndimor dhe, në këtë mënyrë, do të ketë një vend të rëndësishëm në përpjekjet për të ndihmuar rajonin. Nga perspektiva e një Bashkimi European me interes në ruajtjen e stabilitetit në kufijtë e tij, përfitimet janë të qarta. Nga perspektiva e qeverive rajonale, nuk ka asnjë aktor tjetër, i cili do të merrte vendin e Bashkimit European në këto përpjekje. Bashkimi European ka investuar shumë në këtë marrëdhënie dhe ka pozicionin më të fortë në lehtësimin e zhvillimit të mëtejshëm në Ballkanin Perëndimor. Për këtë arsye, Bashkimi European: zgjeron programet e tij aktualë, duke u përqendruar në çështje të lidhura specifiktë me emigrimin; dhe stimulon migrimin rrethor midis vendeve me raportet me të lartë të emigrantëve. Aktualisht, migrimi nuk konstatohet në platformat ekzistuese të bashkëpunimit midis BE-së dhe vendeve të Ballkanit Perëndimor. Por duhet të bëhet.

Normat e emigrimit në Ballkanin Perëndimor sipas nivelit arsimor 2010



Burimi: UN

Një pjesë e kësaj qasje tashmë është në praktikë në mënyrë efikase: vende të tilla si Gjermania, tashmë përfitojnë nga nivelet e larta të emigrimit nga Ballkani Perëndimor. Por BE duhet të vijojë më tej duke krijuar skema të transferimit. Këto

mund të përshijnë kurset e të mësuarit në distancë ose punësimin e sponsorizuar, i cili do të mund të ndihmonte që migrimi rrethor të bëhej një normë. Për shembull, trajnimet për doktorët në universitete dhe klinika në BE i jep mundësi punonjësve të aftë të emigrojnë dhe të kthehen. Ata, të cilët largohen nga rajoni, ende mund të kontribuojnë në komunitetin lokal shkencor me anë të kërkimeve, arsimit dhe shkëmbimeve. Rezultati nuk do të ishte i ndryshëm nga ai që erdhi si pasojë e emigrimit rrethor irlandez në Mbretërinë e Bashkuar, si brenda edhe jashtë anëtarësimin në BE. Këto ndryshime do të ndihmonin në mbarëvajtjen dhe përmirësimin e shërbimeve publike në Ballkanin Perëndimor, duke kontribuar në këtë mënyrë në stabilitetin e rajonit - me njerëz të cilët qëndrojnë në atdhe duke u bërë pjesë e avancimit të njohurive të kapitalit njerëzor nga Ballkani Perëndimor.

Faktikisht, [të dhënat](#) tregojnë se një pjesë në rritje e migrimit në BE është rrethore, duke qenë se njerëzit kthehen në vendet e origjinës disa herë. Për Ballkanin Perëndimor, nuk ka asnjë mënyrë më të mirë për të rikthyer aftësitë dhe kapacitetin intelektual, sesa duke promovuar migrimin rrethor. Zgjerimi dhe promovimi i këtij trendi në Ballkanin Perëndimor do të sillte përfitime për të gjithë.

Përfundim: Ballkani Perëndimor pjesë e botës globale?

E ardhmja e Ballkanit Perëndimor mund të jetë globale: diaspora e tij mund ta riaktivizoj dhe ta përtërij atë. Pothuajse 6 milion anëtarë të diasporës, duke përfshirë ata të cilët mund të gjurmojnë origjinën e tyre në Ballkanin Perëndimor, janë në pritje, me eksperiencën, aftësitë, talentin dhe entuziazmin për të transformuar rajonin.

Por për ta realizuar një gjë të tillë, debati në vet Ballkanin Perëndimor duhet të përshpejtohet për të diskutuar çështjen e emigracionit hapur dhe në mënyrë publike. Kjo tematikë është mbajtur pothuajse në heshtje të plotë në dekadat e fundit në Ballkanin Perëndimor. Në vend që të shqetësohen për emigrimin dhe të urojnë që dikush ta ndalojë atë, udhëheqësit e Ballkanit Perëndimor tashmë duhet të befasojnë publikun dhe ndoshta edhe vetveten duke e duke e kthyer emigrimin në një mundësi të madhe.

Duke angazhuar shoqërinë, bizneset dhe publikun në proces, secila prej qeverive të Ballkanit Perëndimor duhet të gjejë një qasje koherente gjithëpërfshirëse. Ato duhet të zbatojnë politika të reja, të cilat promovojnë migrimin rrethor, tërheqin investime, si edhe të inkurajojnë diasporën e Ballkanit Perëndimor të ndihmojnë në zhvillimin e rajonit të tyre qoftë duke rikthyer ose në distancë. Në të vërtetë, krijimi i mundësive për punësim fleksibël gjeografikisht do të rriste zgjedhjet e individëve, duke fuqizuar rrjetet interpersonale, të cilat ruajnë kapitalin njerëzor dhe rrisin shkëmbimin e aftësive.

Për të pasur sukses, qeveritë e Ballkanit Perëndimor do të duhet të bëjnë shumë më shumë për të kuptuar problematikën. Materiale interesante dhe të dobishme mund të zbulohen duke studiuar efektet e emigrimit, duke mbledhur njohuritë dhe statistikat për emigrantët për punësim, për moshën, gjininë dhe fëmijët e emigrantëve. Këto qeveri mund ta përdorin këtë gjë për të përgatitur politikat e ardhshme për emigracionin. Në të vërtetë, shembulli historik i Irlandës tregon se si, gjatë një sërë dekadash, qeveria irlandeze ndërmori dhe iu përkushtua kërkimeve, duke mbledhur të dhëna të besueshme të natyrës që i mungonin më herët, dhe duke përfituar nga aksesin në rritje në teknologji për të kuptuar më mirë diasporën e saj. Në këtë moment, ajo ndërmori një sërë veprimesh, e mbështetur fuqimisht nga shoqëria civile, për të kuptuar diasporën irlandeze dhe rrjetet e tyre, si edhe potencialin e tyre për të sjellë përfitime në atdhe, në Irlandë, si edhe për të kuptuar ndikimin që kishin anembanë globit. Normalisht, që ka ndryshime nëse e krahasojmë me eksperiencën e Ballkanit Perëndimor, por historia irlandeze duhet të shërbejë si frymëzim: ajo demonstroi se si një vend mund të sjellë ndryshime pozitive për veten duke u mbështetur sa më shumë në qytetarët e tij, si tek ata jashtë vendit edhe tek ata në atdhe. Një komunitet global i Ballkanit Perëndimor mund të krijohet, ashtu siç u krijua edhe komuniteti global irlandez.

Dhe nga këndvështrimi i BE-së, shpresa për sukses që vjen nga diaspora e Ballkanit Perëndimor - shumica e të cilëve jetojnë në territorin e tij - duhet të tërheqë një interes të madh. Me proceset për pranim në BE pa asnjë zhvillim, një qasje e re dinamike në të cilën mund të kontribuojë Bashkimi Europian, duhet të rezultojë

tërheqëse për politikëbërësit, të cilët janë në kërkim të mënyrave për të siguruar stabilitetin dhe mirëqenien e Europës. Sondazhet mbi opinionet në të gjithë Europën tregojnë qartë se çdo zgjerim i mëtejshëm i BE do të kundërshtohet mbështetur në perceptimin e rajonit së jashtmi; nivelet e larta të emigrimit dhe ndjesia për një plan paraprak dhe inercie kontribuojnë në këtë imazh.^[15] Duke lënë mënjanë gjuhën angleze, vendet e Ballkanit Perëndimor nuk kanë më pak asete dhe mundësi sesa irlandezët, kur ata ndërmorën një rrugëtim, i cili i solli përfitime vendit të tyre dhe rriti pozicionin e tyre në botë. Njerëzve iu pëlqen të flasin për “fatin e irlandezëve”. Por e vërteta është se ata e krijuan vet fatin e tyre, dhe njerëzit në Ballkanin Perëndimor do të mund të bëjnë të njëjtën gjë.

Rreth autores

Alida Vračić është pjesë e Programit të Europës më të Madhe të KEMJ (ECFR's *Wider Europe Programme*), si edhe bashkëthemeluesja dhe drejtore ekzekutive e Populari, një *think-tank* i vendosur në Bosnje, i cili është i specializuar në integrimin europian në Ballkanin Perëndimor, në politikë, qeverisje, shoqërinë civile dhe demokratizimin në një situatë post-konflikti. Më herët ajo ka punuar për Iniciativën për Stabilitetin Europian, si edhe për Komisionin e të Drejtave të Njeriut në Gjykatën Kushtetuese të Bosnjës. Ajo ka marrë një sërë bursash dhe ka fituar programe stazhi, duke përfshirë bursën Chevening, një program stazhi Stiftung Mercator dhe programin Marshall Memorial Fellowship. Përgjatë punës së saj për integrimin europian të Ballkanit Perëndimor, ajo ka ndjekur projekte kërkimore në lidhje me emigrimin nga rajoni. Përmbledhja e saj mbi politikën, “Rruga e Kthimit: Largimi i trurit dhe Prosperiteti në Ballkanin Perëndimor” u publikua nga KEMJ në vitin 2018.

Falënderime

Autorja dëshiron të falënderojë Adam Harrison për redaktimin e materialit si edhe për përgatitjen e grafikës. Për ndihmën e tyre në këtë projekt, autorja dëshiron të falënderojë: Tania Lessenska, James Hegarty, Kingsley Aikins, Dr John Bradley, Richard

King, Karen Mc Hugh, Ann Derwin, Geoffrey Keating, Raymond Bowe, Simonida Kacarska, Rosita Mahony, and Tena Prelec.

[1] Vendet e Ballkanit Perëndimor përfshijnë: Shqipërinë, Bosnje-Hercegovinën, Kosovën, Kroacinë, ish Republikën Jugosllave të Maqedonisë, Malin e Zi dhe Serbinë.

[2] Raport i Bankës Botërore, Raporti Ekonomik i Rregullt për Ballkanin Perëndimor Nr: 13: Dobësitë, Një Rritje e Ngadaltë, 2018

[3] 1990–2050 (Index: 2015=100 përqind, planifikime nga 2015 e në vijim)*. (Burimi i të dhënave: Kombet e Bashkuara 70).

[4] Susan H Motherway, “The Globalization of Irish Traditional Song Performance”, Routledge, 2013, fq. 106.

[5] Intervistë me zyrtarë të lartë të Departamentit të Punëve me Jashtë dhe Tregtisë të Irlandës, Nëntor 2018.

[9] Intervistë me përfaqësuesit e Irlanda, Shtëpia e Sigurt (Safe Home Ireland), shërbimi për mbështetjen e emigrantëve, Dublin, Nëntor 2018.

[10] Brendan M Walsh, Emigration: Perspektiva e një ekonomisti, 1988-08, UCD Seritë e Qendrës për Punimet në Politikat e Kërkimeve në Ekonomi; PP88/3, Kolegji Universitar, Dublin. Shkolla e Ekonomisë:

[11] Strategjia për Bashkëpunimin me Diasporën 2011-2014, dhe Plani i Veprimit në lidhje me të si edhe një Projektligj për Bashkëpunimin e Malit të Zi me diasporën nga viti 2014.

[12] “Rritje më e Madhe por më e Brishtë”, Raporti i Rregullt Ekonomik për Ballkanin Perëndimor Nr. 14, World Bank Group, Vjeshtë 2018.

[13] Caroline Hornstein-Tomić, Robert Pichler, and Sarah Scholl-Schneider, “Remigration to Post-Socialist Europe/Rückkehr ins postsozialistische Europa”, Erste Stiftung, 2018.

[14] John FitzGerald, “Një Perspektivë Irlandeze për Fonde Strukturore”, Materiali Studimor i Institutit për Kërkime Ekonomike dhe Sociale, Nr. 90, Publikuar tek: Studimet e Planifikimit Europian, Vol. 6, Nr. 6, 1998, fq. 677-694, fq. 9.

[15] Eurobarometri standard 89, Pranverë 2018, Komisioni European.

ABOUT ECFR

The European Council on Foreign Relations (ECFR) is the first pan-European think-tank. Launched in October 2007, its objective is to conduct research and promote informed debate across Europe on the development of coherent, effective and values-based European foreign policy. ECFR has developed a strategy with three distinctive elements that define its activities:

- A pan-European Council. ECFR has brought together a distinguished Council of over two hundred Members – politicians, decision makers, thinkers and business people from the EU's member states and candidate countries – which meets once a year as a full body. Through geographical and thematic task forces, members provide ECFR staff with advice and feedback on policy ideas and help with ECFR's activities within their own countries. The Council is chaired by Carl Bildt, Emma Bonino and Mabel van Oranje.
- A physical presence in the main EU member states. ECFR, uniquely among European think-tanks, has offices in Berlin, London, Madrid, Paris, Rome, Sofia and Warsaw. Our offices are platforms for research, debate, advocacy and communications.
- Developing contagious ideas that get people talking. ECFR has brought together a team of distinguished researchers and practitioners from all over Europe to carry out innovative research and policy development projects with a pan-European focus. ECFR produces original research; publishes policy reports; hosts private meetings, public debates, and “friends of ECFR” gatherings in EU capitals; and reaches out to strategic media outlets.

ECFR is a registered charity funded by the Open Society Foundations and other generous foundations, individuals and corporate entities. These donors allow us to publish our ideas and advocate for a values-based EU foreign policy. ECFR works in partnership with other think tanks and organisations but does not make grants to individuals or institutions.
www.ecfr.eu

The European Council on Foreign Relations does not take collective positions. This paper, like all publications of the European Council on Foreign Relations, represents only the views of its authors. Copyright of this publication is held by the European Council on Foreign Relations. You

may not copy, reproduce, republish or circulate in any way the content from this publication except for your own personal and non-commercial use. Any other use requires the prior written permission of the European Council on Foreign Relations. © ECFR Mar 2019. Published by the European Council on Foreign Relations (ECFR), 4th Floor, Tennyson House, 159-165 Great Portland Street, London London W1W 5PA, United Kingdom.